

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 3 (tre) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në pozicionet “Specialist IT”, “Sekretare Mësimore”, si dhe “Specialist i SBC, ALUMNI dhe Karrierës”.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist IT” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë minimalisht diplomë të ciklit 3-vjeçar (Bachelor) në programet “Inxhinieri Elektronike”, “Informatike” “Telekomunikacion” apo në fusha të ngjashme;
2. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet të pajisur me certifikatën/dëshminë përkatëse;
3. Të kenë aftësi të mira komunikimi, si dhe aftësi të punës në grup.

B. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare Mësimore” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë “Master i Shkencave”;
2. Të zotërojnë me dëshmi universitare një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
3. Të kenë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike;
4. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave të arsimit të lartë;
5. Të mos jenë larguar nga puna për masa disiplinore.

C. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist SBC, ALUMNI dhe Karrierës” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë “Master i Shkencave”;
2. Të zotërojnë me dëshmi universitare një gjuhë të huaj të BE-së, preferohet anglisht;
3. Të kenë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike;
4. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave të arsimit të lartë;

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **10.11.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.